



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.09.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:09 dhe mbaroi në orën 15:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Brikena Ukperaj**, **znj. Yllka Rupa**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.

2. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).¹

Mbledhja plenare e ditës së sotshme, e orës 15:00, drejtohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit dhe ka për objekt caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Alban Toro për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Çështja do të gjykohej nga një treshe e përbërë nga z. Genti Dokollari, znj. Adelajda Gjuzi dhe z. Laurent Fuçia. Por i pandehuri ka paraqitur një kërkesë me objekt “Shuarje mase sigurimi” gjatë gjykimit të themelit të çështjes. Gjyqtarit {...} i është miratuar kërkesa për heqje dorë me vendimin e datës 30.09.2022 pasi ai më parë ka shprehur mendim. Ndërkohë, gjyqtarja tjetër znj. {...} është gjyqtare e hetimit paraprak. Seanca e radhës është planifikuar për t’u zhvilluar me datë 3 tetor.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit (pasi efektet e krijuara në këtë rast do të ishin negative pasi bëhet fjalë për gjykimin e vetëm 1 çështjeje gjyqësore të veçantë), bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër (si gjykata më e afërt), duke përfshirë edhe gjyqtarin e caktuar në skemën e delegimit pranë kësaj gjykatë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm në shortimin e çështjes të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: znj. Irena Brahimi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Irena Brahimi.

Zoti Toro sqaron se duke qenë se kërkimi kishte të bënte në lidhje me çështjen nr. 313 pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, nga shorti rezultoi që gjyqtarja Irena Brahimi e cila do të jetë pjesë e trupit gjykues që do të gjykojë çështjen nr. 313 pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

Me përfundimin e procedurës së hedhjes së shortit, përfundon dhe trajtimi i relacionit të përgatitur nga Komisioni. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor